



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY  
Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë  
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

### Njoftim për Opinion

Universiteti "Kadri Zeka" asnjëherë nuk ka dashur të bëhet pjesë e thashethëmeve të njerëzve të caktuar, por shkrimet tuaja tendencioze na detyrojnë që të bëjmë një reagim sqarues për opinionin e gjerë.

Pse shpifet pa fakte, nëse një konkurs anulohet për arsye krejt procedurale, e cila ka ndodhur jo vetëm në Universitetin tonë por edhe në shumë institucione të tjera, me të njëjtin qëllim.

Opinionin i gjerë informohet se sistemi i aplikimit për punësim në Republikën e Kosovës bëhet online, përmes Ministrisë së Administratës Publike, ku në mënyrë taksative janë të përcaktuara kushtet e konkursit.

Në sistemin e MAP-it, kur bëhet fjalë për kualifikimin përkatës kërkohet diploma universitare dhe pikërisht Këshilli Pavarur mbikqyrës për anulimin e konkursit ka marrur për bazë faktin se është kërkuara vetëm diplomë universitare dhe se nuk janë cekur drejtimet përkatëse, si: Juridik, Ekonomik, Administratë Publike ose ndonjë drejtim i ngjashëm.

Vetëm sa për sqarim për opinionin e gjerë se Komisioni Përzgjedhës për pozitën: Udhëheqës i Prokurimit është përzgjedhur kandidati, i cili ka qënë Ekonomist i diplomuar dhe i vetmi kandidat që ka poseduar çertifikatën valide për prokurim dhe madje ndaj kësaj pozite nuk ka pasur asnjë ankesë, por që Këshilli i Pavarur Mbikqyrës e ka anuluar vetëm se nuk është cekur se kriteri i kualifikimit të jetë nga drejtimet si: Juridik, Ekonomik, Administratë Publike ose ndonjë drejtim i ngjashëm.

E njëjta situatë ka qënë edhe për pozitën: Menaxher i Personelit.

Kjo mund të shihet qartë dhe vërtetohet edhe me vendimet për anulim të këtyre dy pozitave, prandaj edhe arsyetimet që qarkullojnë nëpër portale sociale se anulimi i këtyre dy pozitave është bërë për qëllime tjera "Nuk Qëndrojnë".

Të dy këto vendime mund të gjinden fare lehtë nëse vizitohet webfaqja e UKZ-së, [www.uni-gjilan.net](http://www.uni-gjilan.net)

Gjilan, 12.07.2017



Sekretari i Përgjithshëm i UKZ-së

Mr.sc. Vaxhid sadriu